



Z. Xhafaj

Tiranë më 4 Korrik 2024

Lënda:

Dërgim i përgjigjes ndaj shkresës për Z. Fatmir Xhafaj, Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar

Zotit Genci Gjonçaj
SEKRETAR I PERGJITSEM
KUVENDI I SHQIPERISE

I nderuar Z. Gjonçaj,

Lutem gjeni bashkëlidhur për Z. Fatmir Xhafaj Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

Ju njoftojmë se shkresa është dërguar dhe me postë elektronike, së bashku me lidhjen ku janë atashuar dokumente që mund të nevojiten për veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

Me konsideratë,

Arjan Dyrmishi

Drejtör Ekzekutiv

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes



Tiranë, më 2 Korrik 2024

Drejtuar: **Z. Fatmir Xhafaj**
Kryetar i Komisionit

Kuvendi i Shqipërisë
Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për
mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në
Bashkimin Evropian”

Lënda: Përgjigje ndaj “Ftesës për Bashkëpunim” nga Organizata e Shoqërisë Civile
datë 28.06.2024

I nderuar z. Xhafaj,

Duke iu referuar shkresës tuaj, përmes së cilës na ftoni të bëhemi pjesë e procesit për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin në Shqipëri, ju falënderojmë për vlerësimin dhe për mundësinë për të kontribuar në këtë nismë të rëndësishme të Kuvendit.

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, ka krijuar një përvojë të konsiderueshëm në fushat e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të kontribuar në forcimin e tyre.

Mbështetur në këtë eksperience jemi të gatshëm të marrim pjesë dhe të japim kontributin tonë në veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Në lidhjen më poshtë do të mund të gjeni dhe shkarkoni dokumente politikash dhe studime të hartuara gjatë pesë viteve të fundit nga Qendra, të cilat mendojmë se janë relevante për fushat që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së komisionit tuaj (<https://www.filemail.com/d/vrauxrddahscdyz>).

Shpresojmë që materialet e dërguara të jenë të dobishme për punën e Komisionit dhe ju falënderojmë për ftesën bashkëpunim,

Me konsideratë,

Arjan Dyrnishi

Drejtor Ekzekutiv

